

AKT THEMELIMI
i Shoqërisë "MULTI MEDICAL CENTER (MMC)" Sh.p.k.

Sot, me datë 04/09/2019,

Zj. Praksithe Zhaka, shtetase shqiptar, atësia Mantho, lindur më 06/06/1944, në Përmet, banuese në: Rruga "Haxhi Dalliu", Pallati G.2, Tiranë, mbajtëse e dokumentit Kartë Identiteti me nr.033927350, madhore e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;

Në përputhje me ligjin 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar) dhe ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", kam vendosur të themeloj një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar "MULTI MEDICAL CENTER (MMC)" Sh.p.k. (më poshtë referuar si "Shoqëria").

NENI 1

EMËRTIMI

Emri i Shoqërisë është "MULTI MEDICAL CENTER (MMC)" Sh.p.k.

NENI 2

SELIA

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresën: Kompleksi Kika 2, Rruga "Tish Dahia", Komuna Parisit, Tiranë 1001, Shqipëri.

Asambleja e ortakëve mund të themelojë filiale, seli dytësore ose njësi të tjera operative si dhe të transferojë selinë e shoqërisë në një adresë apo qytet tjetër.

NENI 3

KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar, përveç zgjatjes ose prishjes së mëparshme të saj sipas vendimit të Asmablesë së Ortakëve.

NENI 4

OBJEKTI

Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj:
Sherbim mjekesor, vizita mjekesore, poliklinike private, ketu përfshihen të gjitha specialitetet mjekesore. Sherbime radiografike, laboratorike, bronkoskopi CT (Skaner), litotript, EKO etj. Sherbim farmaceutik, stomatologjik, kirurgji, reaminacion, ORL, gjinekologji, transferim pacientesh jashtë shtetit për kurime në klinikat e tjera. Import - export, tregti të artikujve mjekesore, asistence teknike në fushën e pajisjeve mjekesore; Tregti të konsumablave medicinale; Import dhe tregtim medikamentesh me shumice dhe pakice; Shitje me pakice të artikujve e pajisjeve mjekesore etj.
Shoqëria në ushtrimin e aktivitetit të saj, do të marrë të gjitha autorizimet e lejet e nevojshme pranë institucioneve publike shqiptare, dhe do të mbështetet në rregullat dhe normat në fuqi në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së saj të rregullt ekonomike.

NENI 5

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar është i përbërë nga kontributet në të holla të ortakëve themelues në vlerën 2.400.000 (dy million e katërqindmijë) Lekë dhe përbëhet nga 1 (një) kuotë.

Kapitali themeltar ndahet si më poshtë:

- **Zj. Praksithe Zhaka**, zoteron 1 kuotë, me 100% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 2.400.000 (dy million e katërqindmijë) Lekë dhe 2.400.000 (dy million e katërqindmijë) Lekë të kapitalit themeltar.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet nëpërmjet kontributeve të reja në para ose në natyrë, sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve të marra më shumicat të parashikuara për ndryshimin e këtij statuti.

NENI 6

ORGANET E SHOQËRISË

Organet e shoqërisë përbëhen nga Asambleja e ortakëve dhe Organi administrativ.

- Asambleja e ortakëve është organi vendimmarrës i shoqërisë e cila vepron në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.
- Organi i vetëm administrativ i shoqërisë është Administratori i vetëm, **Z. Eris Çorbaxhi**, shtetas shqiptar, lindur më 20/10/1991, në Pogradec, mbajtës i dokumentit Kartë Identiteti me nr. 028962726, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, e cila zgjidhet për një periudhë prej 5 (pesë) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.

NENI 7

LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e statutit të shoqërisë, si dhe nga të gjitha dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

NENI 8

DISPOZITA FINALE

Ky Akt Themelimi hartohet në 2 (dy) kopje origjinale në gjuhën shqipe.

Permbajtja e Aktit të Themelimit u lexua dhe nënshkrua nga Ortaku themelues i shoqërisë duke autorizuar **Administratorin, Z. Eris Çorbaxhi**, për të kryer të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) në Tiranë.

ORTAKU THEMELUES

PRAKSITHE ZHAKA

Praksithe Zhaka
Zhaka